VENDIM
Nr. 457, datë 3.7.2019

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR PJESËMARRJE NË QENDRËN E TRAJNIMEVE NË FUSHËN E PRONËSISË INDUSTRIALE, SI DHE PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËRKATËSE *DHE MASËN E SHPËRBLIMIT TË LEKTORËVE*

(Ndryshuar me VKM nr. 327, datë 18.5.2022; nr. 172, datë 19.3.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 193/d, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e procedurave për pjesëmarrje në Qendrën e Trajnimeve në Fushën e Pronësisë Industriale, si dhe përcaktimin e tarifave përkatëse.
2. Ky vendim zbatohet për:
a) personat fizikë dhe juridikë, të cilët aplikojnë për t'u pajisur me certifikatë të kualifikimit profesional në fushën e pronësisë industriale;
b) përfaqësuesit e autorizuar të objekteve të pronësisë industriale, të cilët regjistrohen në modulet e trajnimit të organizuar nga kjo qendër;
c) ekspertët në fushën e pronësisë industriale, të cilët regjistrohen në modulet e trajnimit të organizuar nga kjo qendër;
ç) punonjës të institucioneve të përfshira në sistemin e pronësisë industriale;
d) stafi akademik i universiteteve të ndryshme, të cilët regjistrohen në modulet e trajnimit të organizuar nga kjo qendër;
dh) punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.
3. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:
a) "Qendra e Trajnimeve në Fushën e Pronësisë Industriale", në vijim "Qendra", është pjesë e strukturës organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe zhvillon aktivitete trajnuese në fushën e pronësisë industriale;
b) "Trajner", individi i zgjedhur nga DPPI-ja për të shërbyer si lektor në aktivitetet e Qendrës.
4. Kandidatët, të cilët kërkojnë të marrin pjesë në trajnimet që organizon Qendra, duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme pranë Qendrës, si më poshtë vijon:
a) Kërkesë me shkrim për pjesëmarrje në trajnim;
b) Mandatpagesën sipas tarifës së parashikuar në vendimin nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale", të ndryshuar.
5. Me dorëzimin e dokumentacionit për pjesëmarrje në trajnim, Qendra njofton kandidatët për kohën në të cilën do të organizohet trajnimi.
6. Në përfundim të trajnimit, Qendra lëshon certifikatë kualifikimi për pjesëmarrësit në trajnim.
7. Qendra, në bashkëpunim me strukturat e tjera të brendshme të DPPI-së, harton programin e formimit të vazhdueshëm të punonjësve të DPPI-së, sipas kërkesave.
8. Në programin e formimit të vazhdueshëm të stafit të DPPI-së përfshihen:
a) trajnimi i detyrueshëm në lidhje me pronësinë industriale gjatë periudhës së provës;
b) trajnimi vullnetar i nëpunësve për përparimin e njohurive të tyre.
9. Shfuqizuar.

10. Programet e formimit të vazhdueshëm të stafit të DPPI-së miratohen nga drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së.

11. Qendra informon punonjësit e DPPI-së 30 (tridhjetë) ditë para, pas miratimit nga eprori direkt i tyre për planin dhe kohëzgjatjen e trajnimit.

12. Njohuritë e marra nga trajnimet e zhvilluara për punonjësit e DPPI-së, shpenzimet, të cilat janë siguruar nga fondet të DPPI-së dhe/ose donatorët, konsiderohen si shpenzime kapitale për rritjen e cilësisë dhe nivelit të kapacitetit profesional të institucionit.

13. Qendra mund të aplikojë dy lloje trajnimesh, si më poshtë vijon:

a) Trajnime direkte, me lektorë të pranishëm në qendër;

b) Trajnime on-line.

14. Pagesa e pjesëmarrjes në trajnim duhet të kryhet në llogarinë e DPPI-së, në momentin e regjistrimit.

15. Për trajnimet e parashikuara në këtë vendim, pjesëmarrësi i nënshtrohet testimit në fund të trajnimit. Trajnimi konsiderohet i ndjekur me sukses nëse merr, të paktën, 50% të pikëve në testim.

16. Ambienti dhe logjistika për të dyja këto lloje trajnimesh do të sigurohen nga DPPI-ja.

17. Çdo trajnim zgjat deri në përfundimin e programit, sipas modulit të trajnimit. Një ditë trajnimi është jo më shumë se 6 (gjashtë) orë.

18. Punonjësit e DPPI-së i kryejnë pa pagesë trajnimet pranë Qendrës.

18/1. Masa e shpërblimit të lektorëve, për të cilët lidhet kontratë ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe lektorëve, të jetë, si më poshtë vijon:

a) 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë/orë 60-minutëshe trajnimi, për kontratat me lektorët, të cilët do të përmbushin kriteret e mëposhtme:

i. të zotërojnë një diplomë "Master i shkencave" apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;

ii. të zotërojnë kualifikimin e nevojshëm në përputhje me modulin apo kurrikulën për të cilën do të angazhohen si trajner, të vërtetuar me dëshmi, diploma, për eksperiencën profesionale;

iii. të kenë jo më pak se 5 (pesë) vjet përvojë pune në fushën e pronësisë industriale;

iv. të kenë aftësi të prezantimit dhe të transmetimit të saktë e të qartë të informacionit te pjesëmarrësit;

v. të mos kenë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë;

vi. zotërimi i gjuhës angleze përbën përparësi.

b) 1000 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi për kontratat me lektorët të cilët do të përmbushin këto kritere:

i. të zotërojnë një diplomë universitare;

ii. të zotërojnë kualifikimin e nevojshëm profesional në përputhje me modulin apo kurrikulën për të cilën do të jenë angazhuar si trajner, të vërtetuar me dëshmi, diploma, rekomandime apo vërtetime për eksperiencën profesionale;

iii. të kenë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën përkatëse;

iv. të kenë aftësi të prezantimit dhe të transmetimit të saktë e të qartë të informacionit te pjesëmarrësit;

v. të mos kenë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë;

vi. zotërimi i gjuhës angleze përbën përparësi.

c) 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë, në rastet e hartimit të kurrikulave apo të materialeve të trajnimit për më pak se 6 orë trajnimi 60-minutëshe;

ç) Në rastet e rishikimit të kurrikulave, pagesa të jetë deri në 50% të pagesës së përcaktuar sipas shkronjës "c".

d) Për trajnerët e dërguar në kuadër të një projekti apo marrëveshjeje teknike të lidhur nga DPPI-ja me organizata të huaja në fushën e PI apo zyra homologe, kushtet për pagesat e trajnerëve sipas kësaj pike përcaktohen në marrëveshjen dypalëshe me atë organizatë apo në kontratën e projektit.

19. Punonjësit e institucioneve të përfshira në sistemin e mbrojtjes së pronësisë industriale dhe që i kanë të detyrueshme për procesin kryesor të punës së tyre njohuritë dhe kualifikimet në fushën e pronësisë industriale i kryejnë trajnimet pranë Qendrës, pa pagesë.

20. Tarifat e pjesëmarrjes në trajnimet e organizuara nga Qendra, nga persona të tjerë që nuk bëjnë pjesë në grupin e parashikuar në pikat 18 dhe 19, të këtij vendimi, janë ato të miratuara me vendimin nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale", të ndryshuar.

21. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama